



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PËRMBARIMIT “B.E.S.T 2010”

Nr.102/6.prot

Data, 20 nëntor 2019

URDHËR

Lënda: Sekuestro për asetet e debitorit

Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Biznesit

I nderuar drejtor,

Unë Saimir Hoxha, Përmbaruesi Gjyqësor, pasi studiova dokumentacionin që i përket Urdhrit Ekzekutiv nr.934, datë 17.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës,

KONSTATOVA:

Se pranë kësaj zyre përmbarimore, është depozituar kërkesa e kreditorit për zbatimin e titullit ekzekutiv të lartpërmendur me palë e objekt:

-Kreditor: “GL DISTRIBUTION 2019” SHPK

-Debitor: “SAN KRISTAL” SH.P.K. (Admin z.Pavlo Tartari, NUIS L93905803M)

-Objekti: Detyrim Monetar

Nga shqyrtimi i dokumentacionit del se debitori duhet të përmbushë detyrimin ndaj kreditorit si dhe shlyerjen e tarifave/shpenzimeve përmbarimore gjyqësore.

Debitori duhet të shlyejë detyrimin e përcaktuar në titullin ekzekutiv.

Ende debitori nuk e ka shlyer këtë detyrim e për rrjedhojë QKB mund të nxjerrë një njoftim/shpallje ku të evidentohet ky detyrim, etj.

Për sa më sipër bazuar në nenet 519 e në vijim të K.Pr.C e ligjit nr.26, dt.08.05.2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor” i ndryshuar,

JU KËRKOJ QË:

- 1- Të mbani nën sekuestro asetet që i takojnë debitorit në çdo lloj aktiviteti për të cilin ju keni informacion;
- 2- Të informoni me shpallje ose me punonjësit tuaj, debitorin për këtë detyrim;
- 3- Të më informoni për veprimet tuaja rreth kësaj kërkesë brenda afateve ligjore.

- Bashkëlidhur ju lutem gjeni një kopje të urdhrit ekzekutiv.

**PËRMBARUESI GJYQËSOR
SAIMIR T. HOXHA**



BEST.2010
PERMBARUES.AL

Zyra e Përmbarimit “BEST 2010”

SAIMIR HOXHA PF (NUIS.L02212504F)

Adresa: prapa Prokurorisë Rrethit Durrës

Tel/Fax: 052-22 6000; Cel: 069 20 756 44

E-mail: BEST.2010@PERMBARUES.AL



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Nr.Regj.Them (90109-02984)934
Datë Regjistrimi 16.09.2019

Nr.Vendimi (11-2019-4995) 934
Datë Vendimi 17.09.2019

URDHËR EKZEKUTIMI
NR. 934, DATË 17.09.2019

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e përbërë prej:

GJYQTARI : SHPËTIM REKA

Sot me datën 17.09.2019 unë gjyqtari i vetëm në dhomë këshillimi mora në shqyrtim kërkesën që i përket:

KËRKUES: Ylvi Loçi, i biri i Qamil, i dtl. 28.07.1988, lindur dhe banues në fshatin katund i ri, Durrës

OBJEKTI: Leshimi i Urdherit të Ekzekutimit për titullin ekzekutiv (Fature Tatimore Shitje)

Baza ligjore: Nenet 5, 12, 11, 16, të Ligjit nr.48/2014, datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare".

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës dhe akteve që i bashkëngjiten asaj

KONSTATOVA

Kërkuesi Ylvi Roçi si përfaqësues i Shoqërisë "GL Distribution 2019" shpk ka patur një marrëdhënie kontraktore me Shoqërinë "San Kristal" shpk për të cilën është lëshuar fatura tatimore nr.1, datë 24.05.2019, nr serie 77921552.

Faturat janë nënshkruar pa vërejtje nga të dy palët dhe nuk janë likuiduar nga Shoqëria "San Kristal" shpk.

Meqë titulli ekzekutiv nuk është ekzekutuar vullnetarisht kërkuesi i është drejtuar

Pasi u njoh me provat dhe bazën ligjore të kërimit gjykata çmon se kërkesa është e bazuar dhe duhet të lëshohet urdhri i ekzekutimit vetëm për këtë vendim.

Për sa më lart gjykata çmon se duhet të pranojë kërkesën e palës kërkuese duke lëshuar urdhrin e ekzekutimit për faturën tatimore .

P Ë R K Ë T O A R Ë S Y E

Gjykata bazuar në Neni 6 i Ligjit 48/2014, "Per pagesat e vonuara nga detyrimet kontraktore dhe tregtare", Neni 510/e, 51119 e vijues i Kodit te Procedures Civile.

V E N D O S A

- Pranimin e kërkesës së kërkuarit Ylvi Loçi.
- Të lëshoj urdhrin e ekzekutimit për titujt ekzekutivë; fatura tatimore nr.1, datë 24.05.2019; nr serie 77921552.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të kërkuarit.
- Të urdhëroj Shërbimin Përmbarimor që të ekzekutojë në mënyrë të detyrueshme
- Ky vendim lëshohet vetëm në një kopje.
- Durrës me 17.09.2019

Shpenzimet gjyqësore	
Taksa gjyqësore	200 lekë
Totali	200 lekë

